BREAKING NEWS
VIDEOT NË 'TIK TOK' QË BËNË BUJË NË RRJET, ILD BËN LËVIZJEN E MENJËHERSHME, KËRKON I

AKTUALITET

Tjetër atentat me armë zjarri në Vlorë, plagoset 38-vjeçari, emër i njohur për forcat e policisë

SHKRUAR NGA ALBIONA LIPO
31 MAJ 2021



Një tjetër atentat me armë zjarri ka tronditur Vlorën mëngjesin e djeshëm, teksa i plagosur ka mbetur një 38-vjeçar. Ngjarja ka ndodhur konkretisht në fshatin Kaninë të qytetit bregdetar, në hyrje të banesës së të riut me iniciale E. B. Nga hetimet paraprake dyshohet se autori ka qenë një, i cili i ka zënë pritë 38-vjeçarit duke e qëlluar me rreth 4 plumba. Për shkak të errësirës, fatmirësisht plumbat kanë kapur vetëm pjesën e poshtme të trupit të të riut. Ndërsa mësohet se, gjatë kohës që ky i fundit ka hyrë në banesë, autori ka qenë duke e pritur në këmbë i fshehur pas një shkurreje. Fill pas atentatit është larguar po më këmbë, teksa policia ka qenë në ndjekje të tij, por nuk ka arritur ta kapë, për shkak se pak metra më larg, ai është marrë nga një makinë dhe është larguar. Megjithatë policia nuk ka mundur të bëjë as identifikimin e tij, ku përveç errësirës, mungesa e kamerave të sigurisë në zonën ku ka ndodhur ngjarja, vështirëson punën e grupeve hetimore për të zbardhur ngjarjen e plotë. Çka na lë të kuptojmë se atentati ka qenë i mirëorganizuar, por që është mbyllur me plagosjen jo të rëndë të të riut. Sakaq, për të mësuar detaje dhe për të rënë në gjurmët e autorit, hetuesit kanë marrë në pyetje 38-vjeçarin, i cili mësohet të ketë thënë se nuk e ka arritur ta shikojë autorin ose autorët dhe se nuk ka dijeni se kush mund të jetë, kjo edhe për shkak të errësirës në zonë. Si dhe deri tani janë shoqëruar në komisariat 5 persona, të cilët mund të kenë dijeni për ngjarjen në fjalë. Theksojmë se, pas atentatit, i cili duket se ka qenë një mesazh paralajmërues, 38-vjeçari është dërguar në spital ku po merr mjekime pasi 4 plumba kanë depërtuar në këmbët e tij. Sakaq në vendngjarje janë gjetur disa gëzhoja arme të dyshuar pistoletë.

38-vjeçari i plagosur, subjekt i OFL-së

Nga hetimet e kryera 38-vjeçari me iniciale E. B., i cili mëngjesin e djeshëm ishte shënjestër e një atentati me armë zjarri, rezulton të jetë subjekt i OFL-së. Ai mësohet të ketë qenë disa herë i dënuar për trafik droge dhe armësh përgjatë disa viteve. Më konkretisht sipas hetimeve i riu i plagosur me iniciale E. B., në 2010 ka qenë i dënuar me 7 vite e 6 muaj burg për drogë. Ndërsa në 2015 është kapur me 50 kg lëndë narkotike të llojit marijuanë, e cila ishte paketuar në formë çokollate. Sasia e drogës u kap në vendin e quajtur "Qafa e Kuzum Babasë". Ndërsa theksojmë sërish se lidhur me atentatin, policia ka shoqëruar deri tani 5 persona që mund të kenë dijeni për ngjarjen, e cila mendohet se ka qenë një atentat i mirëorganizuar, pasi gjithçka ka ndodhur në errësirë, por që është mbyllur me plagosjen jo të rëndë të 38-vjeçarit. Sakaq kujtojmë që disa ditë më parë, ngeli i plagosur një 39-vjeçar i identifikuar si E. L., i cili gjithashtu është arrestuar për "Moskallëzim krimi". I riu ishte shfaqur i plagosur në të dyja këmbët me armë zjarri në ambientet e spitalit në zonën ku ndodhi ngjarja, ndërsa kishte deklaruar në polici se ishte vetëplagosur. Megjithatë dy ditë pas ngjarjes policia ka bërë të mundur arrestimin e një 18-vjeçari të dyshuar si autor, si dhe zbardhjen e motivit për të cilën ka ndodhur plagosja. Ky i fundit mësohet të ketë qëlluar me armë zjarri drejt 39-vjeçarit pas një konflikti banal.

Më të lexuarat

Ekzekutimi i biznesmenit në Tepelenë, vjen reagimi i policisë

Të shtëna me armë zjarri në Tepelenë, plagoset rëndë një person, zbardhen detajet e para

Greqia i jep fund bllokadës me Shqipërinë, vendi i parë i BE që heq të gjitha kufizimet e Covid në pikat kufitare, ja cilat janë kushtet e udhëtimit (DATA)

Ndërroi jetë nga Covid-19 disa muaj më parë, ja kush do jetë drejtuesi i ri i 'Patentave' në Gjirokastër (EMRI)

Situata pandemike në Shqipëri, Pipero paralajmëron qytetarët: Vera do të jetë e qetë, por kujdes

Tronditëse! Bieta Sulo shokohet nga denoncimi në studio, vëllai i vogël përdhunohet nga motra e madhe

Zhdukja e mistershme e shefit të Antidrogës së Ulqinit, policia heton në një pistë të re

Bëri bujë në TikTok, publikohen fotot kur kryegjyqtarja e Elbasanit Enkeleda Kapedani sfilonte në "Miss Shqipëria"

Lehtësimi i masave, Brataj thirrje pronarëve të lokaleve: Vjeshta mund të risjellë probleme

Gjykata e Lartë ia kaloi GJKKO çështjen e Fatmir Mediut, Klodiana Lala zbardh detaje: Ja çfarë pritet të ndodhë brenda 10 ditësh

Sherr mes grupeve në Turqi, goditet për vdekje 19-vjeçari shqiptar, plagoset rëndë bashkatdhetari (EMRI)

Hajdari paralajmëron 'TËRMET' në politikën shqiptare dhe flet me emra: Rrjetat janë tërheq për peshqit e mëdhenj! Në objektivin e SPAK-ut janë këta politikanë

Mesazhe Promocionale

Gossip



Lajm i trishtë! Ndahet nga jeta në moshë shumë të re reperi i njohur nga Texas (EMRI+FOTO)

Reperi nga Texas, Lil Loaded, i cili shënoi sukses të madh me kë...

Opinione

PANDELI BARDHI
Sinicë të qaj me lot, pa ty nuk rrimë dot...

RAMAZAN SHERJA
Pse Berisha shpallet tani "non grata" nga SHBA?...

BESI BEKTESHI
Prandaj reforma duhet të largojë dhe "tik tok-u...

PANDELI BARDHI
Shëmbëlltyra "model" e shkeljes së Kushtetutës,...

LEXO OPINIONE TE TJERA